



Datë/a:	21.01.2010
Referenc-ë:	Ankesat me nr. 05-354-16 dhe 05-354-16/1 dt. 08.01.2010
Për/ Za/ To:	Kryesia e Iniciativës Qytetare për Mbrojtjen e Qytetit të Prishtinës, rr."Hilmi Rakovica" nr. 38, Prishtinë
CC:	
Përmes/Preko/Through:	Zyrës Pritëse
Nga/Od/ From:	Drejtoria e Urbanizmit, Kadstrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit Sektori i Inspeksionit të Ndërtimit Ergyn Hajredini, inspektor i ndërtimit
Tema/ Subjekat/Subject:	<b>Njoftim</b>

Kryesia e Iniciativës Qytetare për Mbrojtjen e Qytetit të Prishtinës me ankesën nr. 05-354-16 dt. 08.01.2010, ka kërkuar ndërprerjen e punimeve ndërtimore dhe rrënimin e aneksit të objektit të ndërtuar në kundërshtimin me lejen e ndërtimit në emër të pronarit Shukri Ramadani, rr."Hilmi Rakovica" nr. 29 në Prishtinë dhe rrënimin e pjesës së tejkaluar të objektit të ndërtuar jashtë kriterëve të lejes ndërtimore, nga ana e ndërmarrjes "Tregtia" në ngastrën e pronarit Mustafë Loxha, në rr."Hajrullah Abdullahu" pn në Prishtinë.

Inspeksioni i ndërtimit, pas shqyrtimit të ankesave, dokumentacionit në arkiv dhe daljes në terren, me dt. 19.01.2010, ju njofton se:

1. Me procesverbalin e dt. 12.11.2009 është konstatuar se, pronari Shukri Ramadani, ka filluar aneks ndërtimin, në pjesën e pasme të objektit banesor, me dim. 12.00x5.00 m, pa siguruar lejen e ndërtimit dhe palës i është urdhëruar ndërprerja e punimeve deri në sigurimin e lejes së ndërtimit. Meqë, edhe pas vërejtjes së lartcekur, i njëjti ka vazhduar me punime, Inspeksioni i Ndërtimit me Aktvendimin për rrënim me nr. 05-354-13334 dt. 23.11.2009, ka urdhëruar pronarin që të bëjë rrënimin e aneksit të ndërtuar pa leje të ndërtimit dhe të kthejë hapësirën në gjendje të mëparshme, në të kundërtën Inspeksioni i Ndërtimit do të marr aksion për rrënimin e atij aneksi.

2. Me procesverbalin e dt. 01.10.2009 është konstatuar se, pronari Mustafë Loxha ka filluar gropimin e themelit për të ndërtuar objektin për banim, me dim. 25.00x15.00 m dhe se pala ka prezantuar lejen për rrënimin e objektit të vjetër me nr. 05-351-13664/1 dt. 15.09.2009 dhe lejen e ndërtimit me nr. 05-351-1664 dt. 10.07.2009, dhe palës i është urdhëruar që ti përmbahet dokumentacionit teknik dhe lejes së ndërtimit. Po ashtu, me procesverbalin e dt. 05.11.2009 është konstatuar se pronari ka vazhduar punimet ndërtimore, duke mos iu përmbajtur dokumentacionit teknik – projektit kryesor dhe lejes së ndërtimit, ku sipas projektit dimensionet e objektit duhet të jenë 18.08x12.13 m, ndërsa dimensionet reale në terren janë 29.70x18.65 m. Prandaj, Inspeksioni i Ndërtimit, me Aktvendimin me nr. 05-354-29777 dt. 05.11.2009 ka urdhëruar pronarin që të ndërpresë të gjitha punimet e mëtejme (urdhër të cilin e ka respektuar deri në ditën e fundit të kontrollimit të objektit, me dt. 19.01.2010), si dhe pajisjen me leje të ndërtimit për pjesën e objektit të tejkaluar – që nuk posedon leje të ndërtimit. .

22-01-2010